



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2404/7 Prot.

Pogradec, më 10.06.2026

VENDIM

NR. 73, DATË 09.06.2026

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 28.05.2026 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 30.03.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 28.05.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 21 vota

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 09.06.2026

ORA : 12:00

JANË PREZENT 21 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 28.05.2026 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :**Miratimi i Procesverbalit të datës 30.04.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 30.04.2026.
5. **Projekt – Vendim:**Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Prill 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës emërore për aplikuesit/ familjet e subvencionimit të qerasë në Bashkinë Pogradec.
7. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 14 Ha dhe 7962 ,2, të ndodhura në Njësinë Administrative Trebinjë që mund të jepen me qira.
8. **Projekt – Vendim:** Për nje ndryshim ne VKB nr 128 dt 22.12.2025“ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026", (numri i punonjesve)
9. **Projekt – Vendim:** Për një rishperndarje në VKB nr 128 dt 22.12.2025, “ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026"
10. **Projekt – Vendim:** Për nje rishperndarje ne VKB nr 128 dt 22.12.2025, “ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026"
11. Informacion mbi raportin vjetor të performancës së Bashkisë për vitin 2025.
12. Të tjera.


Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.05.2026

Znj. Prifti: Përshëndetje të gjithëve. Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë mbledhje, e cila zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Ju lutem të vazhdojmë me apelin.

Znj. Bojko: Kryen apelin. Të pranishëm janë 20 këshilltarë.

Znj. Prifti: Duke qenë se janë të pranishëm 20 këshilltarë dhe është plotësuar kourumi I nevojshëm ligjor, mbledhja deklarohet e hapur.

A handwritten signature in black ink, appearing to be the initials 'J.P.' or similar, located in the bottom right corner of the page.

1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.

Znj. Prifti: Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Lexohet rendi i ditës.

Znj. Bojko: Sqaroj se në rendin e ditës pika nr. 11 kalon si pikë nr. 12, ndërsa në vend të saj shtohet projekt-vendimi për barazinë gjinore, pasi konsultimi publik për këtë çështje u zhvillua ditën e premte. Për këtë arsye është bërë ky riorganizim i rendit të ditës.

Znj. Topa: Sipas diskutimeve të zhvilluara ditën e martë në komisione, u vendos që projektvendimi nr. 7 të kalojë për konsultim publik. Gjithashtu, për sa i përket pikës nr. 6, pas debatit të zhvilluar ndërmjet këshilltarëve në komisione, është propozuar ngritja e një grupi verifikimi nga Këshilli Bashkiak, pasi ka pasur kontestime lidhur me listën e përfituesve të paraqitur nga Bashkia. Kjo ishte çështja kryesore e diskutuar në komisione dhe mbetet për t'u vendosur nga Këshilli në mbledhjen e sotme. Ju faleminderit.

Z. Torra: Mirëdita. Jemi të vetëdijshëm që familjet kanë shumë nevojë dhe se ka një numër të konsiderueshëm kërkesash. Duhet të kemi parasysh se kemi të bëjmë me disa kategori mbështetjeje, si bonusi i strehimit, bonusi i qirasë dhe kreditë e buta. Të gjitha kërkesat e paraqitura janë trajtuar sipas procedurave përkatëse. Për bonusin e qirasë janë ndjekur të gjitha hapat ligjorë dhe administrativë, duke marrë në konsideratë mënyrën e ndodhjes së fatkeqësisë, si edhe radhën e paraqitjes së kërkesave nga qytetarët. Pas marrjes së informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm, aplikimet janë shqyrtuar dhe është përgatitur projektvendimi që, sipas vlerësimit tonë, është i plotë dhe i saktë. Pjesa tjetër i takon vendimmarrjes së Këshillit. Aktualisht funksionon një komision i ngritur nga Këshilli, ku marrin pjesë edhe dy përfaqësues të Këshillit Bashkiak, dhe ky komision i ka shqyrtuar kërkesat një nga një. Nëse Këshilli vendos të ngrejë një grup tjetër verifikimi, kjo është e drejtë e tij. Megjithatë, procedura e ndjekur deri tani është në përputhje me kuadrin ligjor. Për çdo të dhënë apo sqarim shtesë që kërkoni, jemi të gatshëm t'juaj vëmë në dispozicion në çdo kohë.

Znj. Topa: Unë mendoj që sot, meqenëse jemi në mbledhje, edhe anëtarët e Këshillit që bëjnë pjesë në komision të japin sqarime se si është ndjekur procedura, në mënyrë që të gjithë të krijojmë një ide më të qartë.

Znj. Prifti: Jam dakord. Kushdo këshilltar që dëshiron të japë mendimin e tij, të marrë fjalën.

Z. Shyti: Unë i qëndroj mendimit që u diskutua ditën e martë në komisione. Janë kërkuar disa dokumente që ende nuk na kanë ardhur. Gjithashtu, nuk kemi një sqarim të plotë për mënyrën se si janë përzgjedhur këto 12 familje. Kjo më lë për të dëshiruar. Në momentin që dokumentacioni i kërkuar nuk na është vënë në dispozicion, mendoj që kjo pikë të mos shqyrtohet sot.

Znj. Prifti: Ju faleminderit, z. Shyti. Kush dëshiron ta marrë fjalën?

Z. Xhyra: Është e drejta jonë si institucion të diskutojmë mënyrën e përzgjedhjes. Pavarësisht se në komision janë dy këshilltarë, edhe ne të tjerët kërkojmë transparencë dhe mundësinë për të verifikuar procesin. Nga sa kemi parë, ka raste që nuk na duken të drejta, pasi ka persona që sipas gjykimit tonë janë

më në nevojë. Kjo është arsyeja pse u diskutua në komisione që të kryhen verifikime dhe më pas çështja të rikthehet për shqyrtim.

Z. Male: Më falni, por unë jam anëtar i komisionit dhe dua të di konkretisht se cili është personi që mendoni se duhet të ishte përfshirë dhe nuk është. Janë marrë shumë vendime për bonus qiraje dhe asnjëherë nuk është ngritur një problem i tillë. Të gjithë kemi votuar për të ndihmuar qytetarët tanë. Nëse doni të ngrini një komision tjetër verifikimi, sigurisht që është e drejta juaj. Mund të merrni dosjet një nga një dhe t'i verifikoni. Nëse konstatooni që dikush e ka merituar më shumë se një familje tjetër, atëherë na tregoni konkretisht ku është gabuar. Nëse ka shqetësime, le të kalojmë në raste konkrete.

Z. Xhyra: Është e drejta jonë për të verifikuar.

Z. Male: Sigurisht, jam dakord me këtë. Nëse keni sugjerime konkrete, mund t'i paraqisni.

Z. Shyti: Kemi të drejtën tonë për të kërkuar verifikim. Ndoshta jo të gjithë i njohin personat në fjalë.

Z. Male: Nuk ka pasur më parë një shqetësim të tillë dhe nuk ka ekzistuar një standard i tillë verifikimi shtesë.

Z. Xhyra: Në asnjë moment nuk duam të penalizohen njerëzit që kanë nevojë. Ne duam që këto fonde të shkojnë tek ata që janë realisht më në nevojë. Nga lista që kemi parë, të paktën sipas vlerësimit tim si anëtar i Këshillit Bashkiak dhe përfaqësues i një zone të caktuar, ka familje më në nevojë sesa disa nga emrat që figurojnë në listë.

Znj. Prifti: Më falni për ndërhyrjen. Nëse nuk jeni dakord me projektvendimin, atëherë mund ta shtyjmë për mbledhjen e ardhshme dhe të ngrihet një grup verifikimi.

Z. Gjona: Më falni për ndërhyrjen, por ne jemi në fazën kur Këshilli duhet të marrë një vendim mbi propozimin e paraqitur. Duhet të vendosim nëse e miratojmë ose jo.

Znj. Prifti: Në rregull, atëherë ta hedhim në votim.

Z. Torra: Më falni, por përpara se të votohet duhet të kemi një arsye të qartë. Janë 12 familje që presin këtë vendim dhe duhet të dinë pse po shtyhet ose refuzohet. Gjithashtu, duhet të na përcaktoni konkretisht çfarë dokumentacioni apo çfarë verifikimi shtesë kërkohet, në mënyrë që të dimë se si të veprojmë më tej.

Znj. Topa: Më falni, por nëse ky projektvendim rrëzohet dhe nuk rikthehet me ndryshime, kjo do të krijojë problematika si për administratën, ashtu edhe për Këshillin Bashkiak. Në komision është kërkuar dosja e pikëzimit.

Z. Torra: Në rregull, dokumentacioni është sjellë. Nëse kërkoni kopje të plota të dosjeve, mund të na thoni edhe raste konkrete dhe t'i diskutojmë.

Z. Balliu: Këtë herë është ndjekur një procedurë shumë e saktë që nga faza e përzgjedhjes. Kërkesat janë administruar në mënyrë elektronike dhe vlerësimi është bërë mbi bazën e pikëve të përcaktuara. Për këtë arsye duhet të ketë një argument të qartë nëse projektvendimi nuk do të votohet, pasi familjet në nevojë presin përfitimin e bonusit të qirasë.



Z. Shyti: Çështja nuk është vetëm çfarë do t'u themi këtyre 12 familjeve, por edhe 32 familjeve të tjera që nuk janë përfshirë. Duhet të kemi një arsye të qartë se përse janë përjashtuar dhe kjo duhet të argumentohet.

Znj. Gjoshe: Më falni, por përse janë njoftuar paraprakisht këto 12 familje? Sipas mendimit tim, njoftimi duhet të bëhet vetëm pas përfundimit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak dhe miratimit të projektvendimit.

Z. Dulellari: Pyetja është shumë e saktë.

Znj. Gjoshe: Nëse personat janë njoftuar paraprakisht, atëherë lind pyetja përse projekti sillet për shqyrtim në Këshill, kur duket sikur vendimmarrja është bërë më herët.

Znj. Prifti: Procedura ligjore parashikon që projektvendimi të kalojë për miratim në Këshillin Bashkiak.

Z. Torra: Personi paraqet kërkesën dhe pas shqyrtimit ne i kemi kthyer përgjigje se është kualifikuar bazuar në dokumentacionin e paraqitur. Gjithashtu u është bërë e ditur se procedura përfundon me shqyrtimin dhe miratimin nga Këshilli Bashkiak dhe më pas me publikimin e vendimit.

Znj. Prifti: Më falni, a jemi dakord që ta vendosim në rendin e ditës?

Z. Male: Nëse ka pretendime konkrete, atëherë të ngrihet komisioni përkatës dhe të bëhen verifikimet. Në të kundërt, kjo po kthehet në një debat pa argumente konkrete.

Z. Gjona: Në këto momente nuk po diskutojmë projektvendimin në vetvete, por rendin e ditës. Kur të vijë momenti i shqyrtimit të projektvendimit, atëherë mund të diskutojmë nëse jemi apo jo dakord me përmbajtjen e tij. Tani duhet të vendosim vetëm për vazhdimin e mbledhjes sipas rendit të ditës.

Znj. Prifti: E hedhim në votim rendin e ditës, pa pikën nr. 7, e cila do të kalojë për konsultim publik.


U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



2. Projekt – Vendim :Miratimi i Procesverbalit të datës 30.04.2026.

Znj. Prifti: Të vazhdojmë me projekt-vendimin nr. 2. Nëse nuk ka diskutime, ju lutem ta hedhim në votim.

U votua

Pro 21

Kundër 0


Abstenim 0

Miratohet Po Jo



3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Znj. Prifti: Vazhdojmë me pikën nr. 3 të rendit të ditës. Nëse ka ndonjë këshilltar që ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, ju lutem ta deklarojë. Nuk u deklarua asnjë rast konflikti interesi.



4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 30.04.2026.

Znj. Prifti: Vazhdojmë me pikën nr. 4 të rendit të ditës. Lexohet materiali i dërguar nga Prefektura.

Znj. Prifti: Duke mos pasur diskutime për këtë pikë, vazhdojmë me pikën nr. 5 të rendit të ditës.

A handwritten signature in black ink, appearing to be the initials 'JP' or similar, located in the bottom right corner of the page.

5. **Projekt – Vendim:** Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Prill 2026.

Znj. Prifti: I japim fjalën përfaqësuesit të administratës për paraqitjen e projektvendimit.

Znj. Luljeta: Për ndihmën ekonomike të muajit prill 2026, procedura e ndjekur është e njëjtë me muajt e mëparshëm dhe dokumentacioni është përgatitur sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Znj. Prifti: Atëherë, le ta hedhim në votim. Ky është një projek-vendim që kalon çdo muaj. A jeni dakord?

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



6. Projekt – Vendim: Për miratimin e listës emërore për aplikuesit/ familjet e subvencionimit të qerasë në Bashkinë Pogradec.

Znj. Prifti: Vazhdojmë me projektvendimin nr. 6. Kush dëshiron ta marrë fjalën?

Znj. Topa: Ajo që unë propozova vjen si rrjedhojë e diskutimeve që u zhvilluan në komisione. Personalisht, për të gjithë ata që kanë aplikuar dhe që e meritojnë përfitim, nuk mund të them se i njohim të gjithë. Për ngritjen e një komisioni verifikimi jam dakord. Gjithashtu, nuk dua të vë në diskutim punën e administratës së Bashkisë, pasi jam e bindur se dokumentacioni është përgatitur në mënyrë të rregullt. Ky projektvendim mund të shtyhet vetëm nëse Këshilli vendos të bëjë një verifikim të detajuar të procedurës. Nëse e rrëzojmë sot dhe vijmë muajin tjetër pa bërë asnjë verifikim konkret, atëherë vetëm sa do të vonojmë procedurën. I gjithë diskutimi po zhvillohet për dy emra dhe mendoj se duhet të dalim në një konkluzion. Për projektvendime të tjera nuk kemi pasur debate të tilla. Ky është opinioni im.

Znj. Shuli: Duke iu bashkuar fjalës së znj. Topa, mendoj se këshilltarët nuk duhet të njoftojnë qytetarët për një projektvendim që ende nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak. Nuk mund të penalizojmë pjesën tjetër të përfutësve për shkak të dy rasteve të diskutuara. Ka familje që e presin këtë mbështetje dhe mendoj se nuk duhet të penalizohen.

Z. Xhyra: Ky projektvendim u diskutua në komisione dhe disa prej personave të interesuar ishin të pranishëm. Ne menduam se disa raste duhej të rishikoheshin dhe për këtë arsye u ngritën diskutimet që po zhvillohen sot.

Znj. Topa: Më vjen keq t'ju kundërshtoj, por më parë nuk ka ndodhur që komisionet të mos kenë pasur kuorumin e nevojshëm për shqyrtimin e çështjeve.

Z. Xhyra: Atëherë, cila është detyra e komisioneve?


Znj. Topa: Cili komision e ka marrë këtë vendim?

Z. Haxhillari: Unë e interpretoj ndryshe këtë situatë. Askush nuk e pengon Këshillin Bashkiak që të monitorojë çdo projektvendim që kthehet në vendim. Edhe nëse projektvendimi kalon sot, mund të ngrihet një grup pune për të verifikuar rastet dhe procedurat e ndjekura. Në këtë kuadër, mendoj se mund ta miratojmë projektvendimin dhe më pas të vazhdojmë diskutimin për problematikat e ngritura.

Z. Shyti: Meqenëse po diskutohet vetëm për dy emra dhe thuhet se nuk duhet të penalizohet pjesa tjetër, pyetja ime është për familjet e tjera që nuk janë përfshirë në listë. Çfarë do t'u

themi atyre dhe pse nuk janë përzgjedhur?

Z. Torra: Nuk po themi që këto familje janë skualifikuar dhe nuk do të përfitojnë. Ato janë aktualisht në pritje, pasi fondi që kemi në dispozicion mbulon vetëm 12 rastet e para sipas renditjes së pikëzimit. Nëse në vijim do të ketë ndryshim buxheti dhe fonde shtesë, do të trajtohen edhe rastet e tjera sipas renditjes



përkatëse. Nuk po themi se nuk do të trajtohen. Çdo rast shqyrtohet individualisht. Mund të ketë persona me kushte të ndryshme ekonomike, por nëse plotësojnë kriteret dhe dokumentacioni i tyre është i rregullt, atëherë trajtohen sipas procedurës.

Z. Xhyra: Unë vazhdoj të mendoj se ka familje që janë më në nevojë. Jam i gatshëm të mbaj përgjegjësi për këtë që them. Le të ngrihet një komision verifikimi që të shqyrtojë si familjet që janë në listë, ashtu edhe ato që nuk janë përfshirë. Nëse rezulton se të gjitha rastet janë trajtuar sipas kriterëve dhe plotësojnë kushtet, atëherë do të kërkoj falje publike.

Z. Torra: Ky është një program social dhe lista është hartuar mbi bazën e sistemit të pikëzimit. Nuk po themi që nuk ka familje të tjera në nevojë. Ka shumë aplikime edhe në programe të tjera sociale, si programi për përmirësimin e kushteve të banesës. Janë rreth 100 kërkesa të shqyrtuara, për të cilat janë mbajtur procesverbale dhe dokumentacion për çdo rast veçmas.

Z. Xhyra: Ka raste kur Policia e Shtetit detyrohet të nxjerrë banorët nga banesa për shkak të rrezikut të shembjes. Në këto raste mendoj se familjet duhet të trajtohen me bonus qiraje dhe, në momentin që Bashkia krijon mundësitë financiare dhe procedurale, familja të rikthehet sërish në banesën e rehabilituar.

Znj. Irsa: Ndhima financiare është e ndryshme nga bonusi i qirasë dhe bonusi i qirasë është i ndryshëm nga programi i rehabilitimit të banesave që ne paraqesim për miratim.

Z. Xhyra: Në cilat raste përdoret bonusi i qirasë?

Znj. Irsa: Që një familje të përfitojë bonus qiraje, duhet të plotësojë kriteret përkatëse dhe të ketë mundësi për të vazhduar procesin e rehabilitimit të banesës. Këto janë tre forma të ndryshme mbështetjeje dhe trajtohen sipas programeve përkatëse.

Z. Gjona: Në këtë Këshill, të paktën gjatë tre viteve që kam qenë këshilltar, nuk kam parë ndonjë rast ku të jetë diskutuar kaq gjatë për ndihmat që janë dhënë. Këshilli ka të drejtë në çdo kohë të ngrejë një komision verifikimi, jo vetëm për këto raste, por edhe për raste të tjera. Mund t'ia lëmë detyrë vetes ngritjen e një komisioni të tillë dhe të kryejmë verifikimet përkatëse. Nuk e kuptoj pse po zgjatet kaq shumë ky debat.

Znj. Prifti: Ju lutem, ta hedhim projekt-vendimin në votim dhe më pas mund të kryhen verifikimet e nevojshme.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



7. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB nr 128 dt 22.12.2025“ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026”, (numri i punonjesve)

Znj. Prifti: Kush dëshiron ta marrë fjalën? Ju lutem të mbajmë pak qetësi dhe të dëgjojmë përfaqësuesin e Bashkisë.

Znj. Laura: Nga 257 punonjës që është aktualisht numri i personelit, propozohet shtimi i 10 punonjësve për çerdhen e re.

Znj. Andoni: Me hapjen e çerdhes së re kemi rreth 30 fëmijë të regjistruar, kryesisht nga çiftet e reja, ndërkohë që ende nuk është publikuar njoftimi zyrtar.

Znj. Prifti: Kisha një pyetje. Meqenëse e keni parashikuar këtë strukturë, sa efektive mendoni se do të jetë?

Znj. Andoni: Do të kemi një përgjigje më të qartë deri në fund të muajit qershor. Ky është parashikimi ynë aktual dhe synimi është që çerdhja të funksionojë sa më mirë dhe të përmbushë nevojat e komunitetit.

Znj. Prifti: Ju lutem, ta hedhim në votim.

Z. Pikuli: Një pyetje. A mendoni se ngarkesa aktuale e personelit është në nivelin e duhur? A është bërë ndonjë monitorim i kësaj situatë?

Znj. Prifti: Bëhet fjalë për një ngarkesë të plotë të kapaciteteve ekzistuese.

Z. Pikuli: Nuk e kam fjalën vetëm për kapacitetin, por nëse ngarkesa e punës është realisht e plotë.

Znj. Andoni: Jo, aktualisht personeli është i mbingarkuar.

Z. Pikuli: Kjo është ajo që doja të dëgjoja.

Znj. Andoni: Kërkesa për shtimin e personelit është bërë pikërisht për çerdhen e re. Një nga arsyet kryesore të hapjes së saj është mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme në strukturat ekzistuese.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

